



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

## **THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSË STUDIMI NË PROGRAMIN YES**

**YES** (Kennedy Lugar-Youth Exchange and Study) është një program pa pagesë që ofron bursa studimi për nxënësit e shkollave të mesme nga Shqipëria për të studiuar një vit shkollor (2024-2025) në një shkollë të mesme amerikane, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke jetuar me familje amerikane.

Fokusi i programit është zhvillimi i komunikimit ndërmjet qytetarëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendeve partnere, me qëllim rritjen e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Nxënësit jetojnë në një familje pritëse amerikane, ndjekin shkollën e mesme, angazhohen në aktivitete për të mësuar mbi shoqërinë dhe vlerat amerikane.

Ky program mbështetet financiarisht nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Këtë vit, fazat e para të testimit do të jenë online nga data 1 gusht 2023 deri 24 tetor 2023. Duhet të regjistroheni në faqen: <http://ais.americancouncils.org/yes>, ku duhet të plotësoni fillimisht një aplikim të përbërë prej disa pyetjeve biografike dhe 3 eseve të shkurtra.

### **Kriteret për të aplikuar:**

- të keni lindur në periudhën nga 1 janar 2007 - 15 korrik 2009 dhe të jeni nxënës në shkollë të mesme në Shqipëri, në klasën e 10-të ose të 11-të - të jeni nxënës me rezultate të mira;
- të keni njohuri të mira të gjuhës angleze;
- të jeni shtetas shqiptar;
- Nxënësit me aftësi të kufizuar duhet të jenë të lindur nga 15 shkurt 2006- 15 korrik 2009 dhe të jenë në cilëndo klasë.

Për çdo pyetje mund të kontaktoni në adresën elektronike: [yes.al@americancouncils.org](mailto:yes.al@americancouncils.org)

**SUKSESE!**